



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Glllogoc

Udhëheqësi i Personelit

01Nr. 111-16967 dt. 26/03 /2018

Bazuar në nenin 11 dhe 12, paragrafi 1.1 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit shpall:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën: Inspektor i Ndërtimit

Numri i kërkuar për pozitën; 1(një) Inspektor i Ndërtimit

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Glllogoc
Nr. i references:	1
Pozita e punës:	Inspektor i Ndërtimit
Institucioni:	Drejtoria e Inspekcionit
Divizioni/njësia:	I Karrierës
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7 , Drejtoria e Inspekcionit, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore

1. Inspektimi i ndërtimit, ku përfshin ngritjen, instalimin, renovimin dhe zgjerimin e ndërtesave;
2. Inspektimi ndryshimi, ndërrimi i destinimit dhe rrënimin e çfarëdo ndërtese a strukture;
3. Inspektimi i kushteve urbanistike – teknike (pëlqimi urbanistik);
4. Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektin e ndërtimit, lejet e ndërtimit);
5. Inspektimi i lejeve të përdorimit të objekteve (pas përfundimit të fazës së ndërtimit);
6. Mbikëqyrja e rrënimin të objekteve të ndërtuara pa leje;
7. Nxjerr procesverbale, aktvendime për ndërprerjen e punëve;
8. Bën propozim për nxjerrjen e aktvendimit për rrënim dhe konkluzës për lejimin e përmbarimit të aktvendimit;
9. Ushtron fletëparaqitje për shkelje të dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtje dhe vepër penale;
10. Kryen edhe detyra tjera të parapara me ligj, rregullore dhe akte tjera nënligjore;
11. Të raportoj për punën e bërë, raporte periodike, mujore, vjetore, etj.

Kualifikimi i nevojshëm arsimor, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës , 3 vjet përvojë pune Profesionale.
- Njohje kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access),
- Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.

Një përshkrim i shkurtër i përzgjedhjes si dhe një përshkrim i Rregullorës ekzistuese e cila rregullon çështjen e rekrutimit:

Përzgjedhja bëhet në bazë të listës së ngushtë e cila hartohet pas rezultateve të testit me shkrim dhe pas intervistës me gojë në bazë të Rregullorës për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, nr. 02/2010.

Kohëzgjatja e emërimit : I karrierës.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **26/03/2018** deri më **09/04/2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikim arsimor të noterizuar dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këto vende pune, për të cilat konkurohet.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shalljes në hyrje të komunës.



Udhëheqëse e Personelit

Hamumshahe Shabani